LIGJ
Nr. 50/2018

PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN "EFICIENCA ENERGJETIKE PËRMES SEKTORIT BANKAR", RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 89/2015

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Denoncimi

Denoncohet marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin "Eficienca energjetike përmes sektorit bankar", ratifikuar me ligjin nr. 89/2015.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2018

Shpallur me dekretin nr.10853, datë 31.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN "EFICIENCA ENERGJETIKE PËRMES SEKTORIT BANKAR"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë Republikës dhe Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar, si partnerë;

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 18 maj 2010,

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë u jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose huamarrësve të tjerë që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja qeveritë, të marrin:

për projektin "Eficienca energjetike përmes sektorit bankar", një hua me kushte të favorshme nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW)*, e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vleftë prej deri në 12.000.000 EUR (me fjalë: dymbëdhjetë milionë euro),

kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe, kur Shqipëria vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë zotohet të mos e pengojë projektin dhe të përkrahë qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë kundrejt marrësit, lidhur me pretendimet eventuale për kthimin e huas, për shkak të përdorimit të saj të padrejtë. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau* hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas nenit l, paragrafi 2, do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis *Kreditanstalt für Wiederaufbau* dhe marrësve të huas dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies dhe të financimit nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën e përmendur në nenin 1, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2018.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron *Kreditanstalt für Wiederaufbau* nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin

e kontratave të përmendura në nenin 2, paragraf 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezulton nga dhënia e huas dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë dhe nxjerr, në rastet e duhura, lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më_____, në dy origjinale, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë
Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë